

## AKT – THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “ Work Zone ” sh.p.k.

Sot ne daten 06.08.2021 , un ortaku themelues :

**Z. Limoz Pali , shtetas norvegjez, i datelindjes 25.10.1973 , atesia Ilia, lindur ne Korce , banuese ne , Saxild gate 10/3117 Tonsberg , Norvegji , i pajisur me pashaporte norvegjeze nr 32128681 , leshuar me date 24.11.2016 , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.**

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” , kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “ Work Zone ” sh.p.k.

#### NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet “ Work Zone” sh.p.k. dhe eshte person juridik shqiptar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901, date 14.04.2008, si edhe te ligjit per QKR-en.

#### NENI 2 SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne adresen : Rruga Frosina Plaku nr 4 Tirane .

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kryej aktivitetet si me poshte :

Sherbimin e punesimit dhe trajnimit te personelit per Shqiperi dhe jasht shtetit.

#### NENI 4 KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise “Work Zone ” sh.p.k. eshte 10.000 (dhjetemije) leke

Ky kapital perbehet nga 1- nje kuote dhe zoterohet nga :

Z. Limoz Pali qe zoteron 100 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 10.000 leke .





**NENI 5  
KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

**NENI 6  
ORGANET E SHOQERISE**

- Asambleja e pergjithshme
- Administratoret

**ASAMBLEJA E PERGJTHSHME**

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesave dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likujduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga aministratoret, perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti

**ADMINISTRATORET**

**Administrator i shoqerise do te jete Z. Ervin Zemblaku , shtetas shqiptar, i datelindjes 20.09.1987, atesia Festim , lindur ne Tirane , banues rruga Ylber Bylykbashi , ndertesa nr 2 hyrja nr 5 ap 7 Tirane , i pajisur me id nr I70920066C, leshuar me date 06.07.2020, i cili emerohet per nje periudhe 1-vjecare, me te drejte ripertesitje.**

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga asambleja,me shumice te thjeshte te votave,me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 51 % te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.





**NENI 7**  
**SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE**

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

**NENI 8**  
**PRISHJA E SHOQERISE**

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- b) me vendim te asamblese se pergjithshme
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- c) ne se nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perpurhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 per "QKR"
- d) me vendim te gjykates
- dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut

**NENI 9**  
**LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Ne rast te likujdimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emerone nje likujdator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likujdimit.

Me vendim e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likujdatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likujduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

**NENI 10**  
**PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT**





Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon crregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likujduesit nuk mund te kundershohet pas crregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

**NENI 11  
MOSMARREVESHJET**

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kundert, ortaket themelues do ti drejtohen Gjykates kompetente per zgjidhje.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**“ Work Zone ” sh.p.k.**

**Limosz Pali**

Limosz Pali

